

S. Stojanović  
Arq. Koc  
26.05.2021



PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
Nr 68/56 Prot.  
Datë 26.05.2021.  
DREJTORIA Skender Jusufi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË**

Nr EXTRA prot(E.I)

Datë 24.05.2021

**Lënda: Dërgojmë raportin vjetor**

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
Rr Qemal Stafa, Nr 1, Tiranë  
TIRANË**

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë u janë vënë në dispozicion të dhënat në lidhje me veprat e hetuara nga ana jonë përgjatë vitit 2020, si në rang veprash të ndjekura ashtu dhe në rang statistikor, apo të dhëna të tjera, sipas kërkimeve ligjore.

Raporti i shkruar në formatin bashkëlidhur, po ju dërgohet në këtë periudhë kohore për shkaqe objektive, duke përfshirë dhe ato të natyrës shëndetësore, ku detajet u janë bërë të njohura edhe Juve.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**DREJTUESI I PROKURORISË  
Elizabeta MERAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË**

**R A P O R T**

**MBI ECURINË E PUNËS  
TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË  
PËR VITIN 2020**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë përgjatë vitit 2020, ka realizuar ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e çështjeve në gjykim, konform kompetencës lëndore dhe tokësore, sipas parashikimeve të normave procedurale.

Forcimi i kapaciteteve në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2020, ka qënë baza e veprimtarisë së punës në këtë prokurori, duke u fokusuar në drejtimet që lidhen me mirëfunksionimin e punës në prokurori, bashkërendimin me institucionet e tjera, rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional, përmirësimin e cilësisë së referimeve dhe efikasitetin në hetime.

Ushtrimi i ndjekjes penale në mënyrë të pavarur, objektive, mbi baza ligjore ka qënë baza kryesore e punës së këtij institucioni. Edhe në rangun e përfaqësimit të akuzës në gjykim për çështjet, është realizuar një punë e kënaqshme, duke u evidentuar dhe problematika të ndryshme.

Gjatë vitit 2020 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë ka vijuar puna edhe ne kushtet e pandemisë, duke u përpjekur për të mos lënë mënjanë ndjekjen penale në lidhje me veprat penale kundër shëndetit dhe jetës, në fushën e krimin ekonomik, kundër autoritetit të shtetit të kryer nga shtetas, vepra penale kundër mjedisit apo veprave të tjera penale të parashikuara në legjislacionin penal.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 nga prokurorët e kësaj prokurorie i është kushtuar rëndësi dhe përdorimit më efektiv të instituteve procedurale si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë, duke qartësuar kuptimin dhe zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor përkatës.

Janë marrë masa për hartimin dhe nxjerrjen e rregullave standard për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë që sigurojnë efikasitet në organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës, si dhe respektimin maksimal të pavarësisë së prokurorëve duke tentuar forcimin e kuptimit më të mirë të përgjegjësive nga çdo prokuror.

Problematikat kryesore të prokurorisë lidhen kryesisht me: a) rritjen e efektivitetit në procesin e ndjekjes penale dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, me qëllimin kryesor arritjen standarteve më të larta në aktivitetin institucional; b) garanci më të mëdha në procesin e punës të prokurorisë, në pavarësinë, performancën dhe efektivitetin në punën e prokurorëve, dhe c) përmbushjen me sukses të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të organit të Prokurorisë.

Nxjerrja e udhezimeve nga Prokurori i Përgjithshëm, ka ndikuar në rritjen e bashkëpunimit institucional, si dhe kanë shërbyer për vënien e bazave drejt një llogaridhënie përpos respektimit të pavarësisë së prokurorëve në vendimarrje.

Gjatë vitit 2020, kjo Prokurori përballoi një ngarkesë relativisht të lartë, përse i takon numrit të materialeve të shqyrtuara, kallzimeve të trajtuara dhe procedimeve penale të hetuara.

Në këtë analizë do të trajtojmë në mënyrë të detajuar treguesit sasiorë dhe cilësorë të punës në tërësi të kësaj Prokurorie.


Qëllimi kryesor i analizës është të evidentojë të gjithë ecurinë e punës tonë me të metat dhe dukuritë pozitive të hasura, duke i lënë vetes mundësinë që për vitin në vijim të mundohemi të bëjmë përmirësime aty ku ka vend në drejtim të përsosjes.

Fillimisht do të trajtojmë në formë statistikore të gjitha të dhënat e evidentuara gjatë këtij viti, duke kaluar më pas në një analizë të thellë të tyre dhe të gjithë problemeve që janë hasur.

## I. MËNYRA E FILLIMIT TË NDJEKJES PENALE DHE KALLËZIMET E REGJISTRUARA GJATË VITIT 2020

Gjatë këtij viti në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë janë regjistruar gjithsej **16879** kallëzime penale. Po ti referohemi të dhënave statistikore të një viti më parë, rezulton që përgjatë vitit 2020 ka një ulje të numrit të kallëzimeve të regjistruara.

Ulja e numrit të kallëzimeve mundet të interpretohet edhe në drejtim të rrethanave objektive që lidhen me situatën e krijuar për shkak pandemie.



Në nivelin krahasimor me një vit më parë, konstatohet se janë regjistruar **disa (mbi një mijë)** kallëzime më pak.

Edhe përgjatë këtij viti marrja dijëni për veprën penale është bërë në nivele të ndryshme sipas normave procedurale ku më së shumti janë referimet e bëra nga policia e shtetit. Prokurori dhe policia marrin dijëni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët. Normalisht janë hasur raste të kallëzimeve të bëra nga nëpunësit publikë, në kushtet në të cilat normat procedurale parashikojnë se nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijëni për një vepër penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale.

Në realizim të këtij detyrimi ligjor kallëzimet janë paraqitur prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore.

Kur, gjatë një procedimi civil ose administrativ, është zbuluar një fakt që përbën vepër penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës ka dërguar aktet në prokurori.

Normalisht në çdo situatë ka patur kujdesin e duhur që kallëzimi të plotësojë kriteret formale duke përmbajtur elementet thelbësore të faktit, burimet e provës, gjeneralitetet, banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit të cilit i atribuohet fakti, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të sqarojnë rrethanat e faktit.

Normalisht që sipas normave procedurale janë hasur dhe kallëzime të bëra nga personeli mjekësor. Personeli mjekësor që është i detyruar ligjërisht të bëjë kallëzim duhet ta paraqesë atë brenda dyzet e tetë orëve dhe t'ia dërgojë prokurorit ose çdo oficeri të policisë gjyqësore të vendit ku ka kryer ndërhyrjen ose ka dhënë ndihmën dhe kur ka rrezik nga vonesa, oficerit të policisë gjyqësore më të afërt. Kallëzimi nga personeli mjekësor tregon personin të cilit i është dhënë ndihma dhe, kur është e mundur, gjeneralitetet, banimin e tij dhe çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar, si dhe rrethanat e faktit, mjetet me të cilat është kryer dhe pasojat që ka shkaktuar.

Kur disa persona kanë dhënë ndihmën e tyre mjekësore për të njëjtin rast, të gjithë janë të detyruar të bëjnë kallëzim, me të drejtë që të përpilojnë dhe të nënshkruajnë një akt të vetëm.

Një numër të konsiderueshëm e zënë kallëzimet e bëra nga ana e shtetasve, duke qënë se ligji parashikon se cdo person që ka marrë dijeni për një veprë penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë.

Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.

Është respektuar formati i detyrueshëm ligjor sipas të cilit ‘Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren’, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

Në nivel statistikor, gjatë vitit 2020 kallëzimet kanë ardhur në përqindjen më të madhe nga Policia e Shtetit – 13654 kallëzime, 757 nga shtetasit; 314 nga nëpunësit publikë; 1 procedim është filluar kryesisht.

Vihet re një ulje e procedimeve të filluara kryesisht, çfarë na ben të ndalojmë dhe të analizojmë shkaqet e kesaj tendence, të cilat mundet ti ndajnë në shkaqe objektive dhe subjektive. Në rangun e shkaqeve objektive mundet të rendisim:

Situatën e krijuar për efekt pandemie,


Ngarkesën fizike të prokurorëve të kësaj prokurorie.

Ndërsa në rangun e shkaqeve subjektive mbetet për ti nënvizuar, perceptimi i krijuar për efekt të procesit të rivlerësimit, i cili ndikon në psikologjinë tërësore të prokurorëve që ushtrojnë detyrën, por passjell dhe një lloj stepje të tyre në drejtimin e përfshirjes me iniciativë drejt hetimit të fenomeneve të ndryshme.

Nr	Referuar nga Institucione ose shtetasit	Nr.i Kallzimeve	
		Viti 2019	Viti 2020
1	Policia e shtetit	14004	13654
2	Shtetasit	1524	747
3	Nëpunësit publikë	398	314
4	Policia e ndërtimit	---	---
5	OSHEE	---	---
6	Policia pyjore	---	---
7	Filluar kryesisht	5	1
8	Policia ushtarake	--	--
	<b>Gjithsej</b>	<b>18069</b>	<b>16879</b>

Për të krijuar një ide më të qartë sa u përket referimeve tabela e mësipërme ilustron edhe nga grafiku vijues:

## Referime 2020



Edhe këtë vit, i është kushtuar vëmendje studimit dhe verifikimit të materialit kallzues, me qëllim evidentimin e regjistrimeve të pabazuara të procedimeve penale, shmangien e hetimeve të panevojshme, garantimin e të drejtave e lirive themelore të shtetasve dhe kostot e tepërta financiare të hetimeve.

E parë në këtë këndvështrim mbetet akoma një element për tu përmirësuar, në drejtim cilësisë së referimeve të bëra nga policia e shtetit si dhe në drejtim të evitimit të materialeve që nuk përmbajnë elementë të figurës së veprës penale.


Për një pjesë të kallzimeve koha mesatare për kryerjen e verifikimeve ka qënë relativisht e gjatë.

Ngarkesa mesatare vjetore e materialeve kallzuese për çdo prokuror, varion në rreth **268** materiale. Një ngarkesë e tillë është e madhe gjë e cila sjell edhe vonesa në përfundimin në kohë të tyre.

Në tabelën në vijim, paraqitet shpërndarja sipas veprave penale, për të gjitha rastet kur është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Veprat penale të grupuara sipas krerëve	Nr. i mosfillim	
	2019	2020
Kr.I Krime K/Njerëzimit	---	---
Kr.II V.P K/Personit	<b>1511</b>	<b>1567</b>
Kr.III V.P K/Pasurisë dhe Ekonomi	<b>2400</b>	<b>2229</b>
Kr.IV V.P K/Mejdisit	<b>15</b>	<b>43</b>
Kr.V Krime K/Pavarës. R/K	----	----
Kr.VI Krime Cën/Marrdh.Shte	----	----
Kr.VII Akte Terroriste	----	----
Kr.VIII V.P K/Autorit.Shtetit	<b>1788</b>	<b>1458</b>
Kr.IX V.P K/Drejtësisë	<b>85</b>	<b>70</b>
Kr.X V.P Prekin. Zgjedh. e Lira	--	--
Kr.XI V.P Kryera nga Band. Arm	---	---
Vepra të tjera	<b>1798</b>	<b>1418</b>

<b>TOTALI</b>	<b>8115</b>	<b>6787</b>
---------------	-------------	-------------



Vlen të analizojmë se, në këtë grup veprash penale në **491** raste mosfillimi është vendosur për veprën penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i K.Penal, në **349** raste për veprën penale “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90 i K.Penal dhe në **245** raste për veprën “Plagosja e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i K.Penal.

Përsa i takon veprës penale të parashikuar nga neni 84 i K.Penal edhe këtë vit është patur parasysh në mënyrë rigoroze, kërkesa e ligjit material penal që kanosja të ketë qënë serioze.

Në krahasim me një vit më parë, është ulur numri i rasteve kur është vendosur mosfillimi i procedimit penal, përse u takon veprave penale të parashikuara në kreun e III, të Kodit Penal.

Ulja e numrit të mosfillimeve, për sa i takon këtij grupi veprash penale, shpjegohet me faktin se është ulur numri i rasteve për materialet kallzues në lidhje me këto vepra penale të referuara.

Në grupin e veprave të parashikuara në kreun e III-të, në **56** raste është vendosur mosfillimi për veprën penale “Falsifikimi i dokumentave”, parashikuar nga neni 186 i K.Penal dhe në **194** raste mosfillimi për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Po në këtë “kre” të Kodit Penal, është vendosur mosfillimi në **323** raste për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143 i K.Penal.

Vendime të tilla janë marrë, pasi nga gjithë të dhënat ka rezultuar e qartë se ndodhemi përpara një marrëdhënie juridiko-civile dhe kallzuesit nuk i janë drejtuar Gjykatës për zgjidhjen e saj, por kanë konsideruar si zgjidhje më të lehtë e më me interes për ta, paraqitjen e kallzimit në Prokurori.

Nuk mungojnë edhe rastet kur ndonjëse kallzuesi ka bërë padi në Gjykatë, paralelisht duke menduar për një zgjidhje të shpejtë, apo me qëllim për të pezulluar gjykimin, bën kallzim edhe në Prokurori. Edhe gjatë këtij viti, të gjitha kallzimet e kësaj natyre janë trajtuar me shumë kujdes, për të shmangur çdo përfshirje të panevojshme të Prokurorisë në zgjidhjen e konflikteve civile midis palëve.

Në grupin e veprave të parashikuara në kreun e VIII-të, në **349** raste mosfillimi është vendosur për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1/2/3/4 i K.Penal.

Të gjitha materialet në lidhje me këtë veprë penale kanë qënë të referuara me persona në gjendje të lirë dhe shumicën e përbëjnë ato raste ku pasoja e ardhur nuk ka qënë ajo e parashikuar në dispozitën penale të këtij neni.

Veprat penale që lidhen me korrupsionin, pastrimin e parave, shpërdorimin e detyrës, kontrabandës dhe veprave penale në fushën e tatimeve, janë vepra sensitive dhe me impakt të gjerë në publik. Pavarësisht shifrave, në hetimin e këtyre veprave penale nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është treguar përkushtimi dhe vëmendja maksimale.

Në lidhje me këto vepra penale, një moment i mirë është dhe krijimi i seksionit të posaçëm sipas Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, ku në vijim priten rezultate në hetim.

## **II. Ushtrimi i ndjekjes penale per veprat e kryera ne bashkepunim, gjatë vitit 2020:**

Me krijimin e Prokurorisë së Posaçme nje sere verash penale qe sipas nenit 75/a i perkisnin kompetences lendore te kesaj prokurorie kane kaluar per kompetence ne prokurorite e rretheve e per pasoje edhe ne Prokurorine prane Gjykares se Shkalles se Pare, Tirane.

Pasja e hetimeve efikase dhe permirësimi i cilësisë së hetimeve nëpërmjet rritjes të numrit të procedimeve penale/të pandehurve të dërguar në gjykatë dhe numrit të pandehurve të dënuar me vendim të formës së prerë, veçanërisht për veprat penale:

- *Trafikimi i shtetasve (N.110/a-110/c,128/b i K.Penal);*
- *Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës (N.138 i K.Penal);*
- *Trafikimi i mjeteve motorrike(N.141/a i K.Penal);*
- *Trafikimi i armëve dhe municionit (N.278/a i K.Penal);*
- *Prodhimi dhe shitja e narkotikëve , trafikimi i narkotikëve dhe Kultivimi i bimëve narkotike(N.283,283/a e 284 të K.Penal).*
- *Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit (N.298 i K.Penal)*

-Rritja e numrit të hetimeve proaktive në lidhje me veprat penale të sipërpërmendura;

-Forcimi i bashkëpunimit me organet dhe agjencitë ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare në rastet e pastrimit të produkteve që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale;

-Rritja e aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore, në funksion të shpejtësisë dhe efektivitetit të së hetimeve;

-Forcimi të kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të agjencive të zbatimit të ligjit me qëllim kuptimin dhe zbatimin e njëjtë të ligjit dhe evidentimin e praktikave të mira.

### **1/b.Lufta kundër trafikimit të shtetasve:**

Gjatë vitit 2020 në lidhje me veprat penale që kanë të bëjnë me trafikimin e shtetasve të parashikuara nga nenet 110/a-110/c dhe 128/b të K.Penal ,si dhe lehtësirave për ushtrimin e këtij aktiviteti kriminal rezulton se nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan është referuar vetëm 1 material hetimor për veprën penale të “Trafikim i personave të rritur” të parashikuar nga neni 110/a i K.Penal,material i cili më pas është regjistruar edhe si procedim penal i ri.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 është regjistruar edhe 1 procedim penal për veprën penale “Trafikim i personave të rritur” të parashikuar nga neni 110/a i K.Penal,i cili ka ardhur për moskompetencë nga një prokurori tjetër.

Gjatë vitit 2020 kanë vazhduar hetimet edhe për 1 procedim tjetër penal të mbartur nga viti 2019 të regjistruar për veprën penale “Trafikim i personave të rritur” të parashikuar nga neni 110/a i K.Penal.

Sa më sipër rezulton se në lidhje me veprën penale “Trafikim i personave të rritur” të parashikuar nga neni 110/a i K.Penal gjatë vitit 2020 janë hetuar 3 procedime penale,pa asnjë person nën hetim,cështje të cilat nuk kanë përfunduar gjatë vitit 2020 dhe janë mbartur për hetim në vitin 2021.

Ndërkohë gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale që u përkasin trafikimit të njerëzve rezulton se ishte ushtruar ndjekja penale për 1 procedim penal të regjistruar si procedim penal i ri. Sic shihet në krahasim me vitin 2019,gjatë vitin 2020 janë regjistruar si cështje të reja 2 procedime penale më shumë.

Në lidhje me fazën e gjykimit, në lidhje me veprat penale që kanë të bëjnë me trafikimin e shtetasve të parashikuara nga nenet 110/a-110/c dhe 128/b të K.Penal ,si dhe lehtësirave për ushtrimin e këtij aktiviteti kriminal,rezulton se gjatë vitit 2020 në gjykatë nuk ka patur cështje të tilla për gjykim.

### **1/c.Lufta kundër trafikimit të veprave të artit dhe kulturës:**

Gjatë vitit 2020,ashtu si dhe në vitin 2019, në lidhje me veprën penale të “Trafikimit të veprave të artit dhe kulturës”të parashikuar nga neni 138/a i K.Penal rezulton se në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan nuk është regjistruar asnjë procedim penal,si dhe gjithashtu në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk është gjykuar asnjë procedim penal.

### **1/c.Lufta kundër trafikimit të mjeteve motorrike:**

Gjatë vitit 2020 në lidhje me veprën penale “Trafikim i mjeteve motorrike” të parashikuar nga neni 141/a i K.Penal rezulton se nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan janë referuar 4 materiale hetimor,materiale të cilat më pas janë regjistruar edhe si procedime penale të reja.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 janë rifilluar edhe 4 procedim penale të viteve të mëparshëm të pezulluara për moszbulim të autorëve të veprës penale “Trafikim i mjeteve motorrike”të parashikuar nga neni 141/a i K.Penal.

Gjatë vitit 2020 kanë vazhduar hetimet edhe për 8 procedime me 1 person nën hetim të mbartura nga viti 2019 të regjistruar për veprën penale “Trafikim i mjeteve motorrike”të parashikuar nga neni 141/a i K.Penal.

Sa më sipër rezulton se në lidhje me veprën penale “Trafikim i mjeteve motorrike”të parashikuar nga neni 141/a i K.Penal gjatë vitit 2020 janë hetuar 16 procedime penale me 1 person nën hetim.

Ndërkohë gjatë vitit 2019 në lidhje me veprën penale “Trafikim i mjeteve motorrike”të parashikuar nga neni 141/a i K.Penal ,rezulton se ishte ushtruar ndjekja penale për 19 procedime penale të regjistruara



të reja sëbahsku me ato të ardhura me moskompetencë,si dhe nuk ka patur procedime penale të mbartura nga viti 2018.

Sic shihet në krahasim me vitin 2019,gjatë vitin 2020 janë regjistruar si çështje të reja 3 procedime penale më pak.

Në lidhje me veprën penale “Trafikim i mjeteve motorrike”të parashikuar nga neni 141/a i K.Penal ,të hetuara gjatë vitit 2020,në lidhje me përfundimin e tyre rezulton se:

- Për 4 procedime është kërkuar në gjykatë dhe është vendosur nga gjykata pushimi i çështjes;
- Për 3 procedime penale është vendosur pezullimi i hetimeve;
- Për 5 procedime penale është shpallur moskompetenca duke ju dërguar aktet prokurorive kompetente;
- 4 procedime penale me 1 person nën hetim janë mbartur për hetim në vitin 2021.

Në lidhje me fazën e gjykimit, në lidhje me veprën penale “Trafikim i mjeteve motorrike”të parashikuar nga neni 141/a i K.Penal,rezulton se gjatë vitit 2020 në gjykatë nuk ka patur çështje të tilla për gjykim që të jenë gjykuar.

### **1/d.Lufta kundër trafikimit të armëve dhe municionit;**

Gjatë vitit 2020 në lidhje me veprën penale të “Trafikimit armëve dhe municionit” të parashikuar nga neni 278/a i K.Penal rezulton se në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan nuk është referuar asnjë material hetimor dhe nuk është regjistruar asnjë procedim penal i ri.

Rezulton se në lidhje me këtë veprë penale ka vazhduar hetimi për 3 procedime penale me 1 të pandehur,procedime këto të mbartura nga viti 2019.

Sa më sipër rezulton se në lidhje me veprën penale “Trafikimit armëve dhe municionit” të parashikuar nga neni 278/a i K.Penal gjatë vitit 2020 janë hetuar 3 procedime penale me 1 person nën hetim.

Ndërkohë gjatë vitit 2019 në lidhje me veprën penale “Trafikimit armëve dhe municionit” të parashikuar nga neni 278/a i K.Penal ,rezulton se ishte ushtruar ndjekja penale për 3 procedimi penale të regjistruara të reja sëbahsku me ato të ardhura me moskompetencë,si dhe nuk ka patur procedime penale të mbartura nga viti 2018.

Sic shihet në krahasim me vitin 2019,gjatë vitin 2020 janë hetuar vetëm 3 procedime penale të mbartura nga viti 2019,pasi nuk është regjistruar asnjë procedim penal i ri.

Në lidhje me veprën penale “Trafikimit armëve dhe municionit” të parashikuar nga neni 278/a i K.Penal,të hetuara gjatë vitit 2020,në lidhje me përfundimin e tyre rezulton se:

- Për 1 procedim penal është vendosur pezullimi i hetimeve;
- Për 1 procedim penal me 1 të pandehur është kërkuar në gjykatë gjykimi i çështjes;
- 1 procedim penal është mbartur për hetim në vitin 2021.

Në lidhje me fazën e gjykimit, në lidhje me veprën penale “Trafikimit armëve dhe municionit” të parashikuar nga neni 278/a i K.Penal,rezulton se gjatë vitit 2020 në gjykatë ende nuk ka përfunduar gjykimi i çështjes me 1 të pandehur të dërguar për gjykim gjatë vitit 2020,çështje e cila është mbartur për tu gjykuar gjatë vitit 2021.

### **1/dh.Lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike, prodhimit,shitjes,transportimit,mbajtjes apo trafikimit të lëndëve narkotike:**

Gjatë vitit 2020,hetimi dhe përfundimi i çështjeve penale në lidhje me veprat penale kundër narkotikëve që përfshijnë prodhimin dhe shitjen e narkotikëve,trafikimin e narkotikëve dhe kultivimin e narkotikëve ka qenë një nga drejtimet ku është fokusuar lufta kundër krimit të organizuar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Përsa i përket burimeve të referimit të materialeve hetimore apo kallëzimeve penale në lidhje me veprat penale që kanë të bëjnë me narkotikët ,rezulton se pjesa kryesore e materialeve hetimore është referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Konkretish, gjatë vitit 2020, nga Shërbimet e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit janë referuar 82 materiale hetimore dhe nga Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve Tiranë janë referuar 7 materiale hetimore.

Gjatë vitit 2020 ,në krahasim me vitin 2019 në këtë prokurori për veprat në fushën e narkotikëve rezulton se janë këto vepra penale janë referuar 7 materiale hetimore më pak.

*Përsa i përket veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” (N.284 i K.Penal) rezulton se kjo vepër është më e përhapur në bashkitë Librazhd, Gramsh e Peqin,ku karakteristikë është fakti se bimët narkotike janë mbjellur në sipërfaqe toke shtetërore pranë kufijve ndarëse të qarkut Elbasan me qarqet e tjera,vende këto ku është shumë e vështirë që të shkohet dhe kontrollohet dhe për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore.*

Gjatë vitit 2020,në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve N.283,283/a e 284 të K.Penal,nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur mosfillimi i procedimit penal në 1 rast për N.283 të K.Penal.

Gjatë vitit 2020 për veprat në fushën e narkotikëve rezulton se janë hetuar në total 170 procedime penale me 136 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 72 të arrestuar,procedime nga të cilat:

-Janë regjistruar si procedime penale të reja 88 procedime me 72 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 38 të arrestuar;

-Ka ardhur me moskompetencë 1 çështje penale;

-Ka vazhduar hetimi për 81 procedime të mbartura nga vitit 2019,me 64 persona nën hetim/pandehur,prej të cilëve 34 të arrestuar.

Ndërkohë gjatë vitit 2019 në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve ,rezulton se ishte ushtruar ndjekja penale për 175 procedimi penale,prej të cilave 94 çështje të regjistruara të reja,4 çështje të ardhura me moskompetencë dhe ,si dhe 77 procedime penale të mbartura nga viti 2018.

Gjatë vitit 2020 ,në krahasim me vitin 2019 në këtë prokurori për veprat në fushën e narkotikëve rezulton se janë regjistruar si procedime penale të reja gjithsej 6 çështje penale më pak,por vërehet se është rritur numri i çështjeve të regjistruara për N.284 të K.Penal në lidhje me kultivimin e bimëve narkotike.


## **II. USHTRIMI I NDJEKJES PENALE DHE HETIMET PARAPRAKE.**

Gjatë vitit 2020 janë hetuar gjithsej **12614** procedime penale me **5482** persona të pandehur dhe nën hetim, nga të cilët **758** me masë shtrënguese arrest (në burg, në burg me afat dhe në shtëpi) dhe pjesa tjetër e tyre me masa të tjera sigurimi dhe në gjendje të lirë. Në numrin e përgjithshëm të procedimeve të hetuara, **3495** prej tyre kanë qënë të mbartura para vitit 2020, **8839** procedime penale janë regjistruar rishtazi, ku për **65** procedime penale janë rifilluar hetimet dhe **188** procedime penale kanë ardhur për kompetencë nga Prokuroritë e tjera.

Të dhënat e përgjithshme përsa i takon procedimeve penale dhe personave nën hetim paraqiten në tabelën në vijim:

EMËRTIMI	ÇËSHTJE		PERSONA NE HETIM		PANDEHUR		ARREST	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
TË MBARTURA	3016	3495	399	668	1103	1153	225	228
TË REGJISTRUARA	9612	8839	1751	1368	2556	2206	531	516
RIFILLUAR	117	65	5	7	12	12	2	2
ARDH.KOMPETE	139	188	27	16	29	41	4	10
<b>GJITHSEJ</b>	<b>12955</b>	<b>12614</b>	<b>2205</b>	<b>2069</b>	<b>3716</b>	<b>3413</b>	<b>762</b>	<b>756</b>


Këto të dhënat përse i takon proçedimeve penale paraqiten në grafikun e mëposhtem :




Ndërkohë gjatë vitit 2020 në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve, rezultojnë se është ushtruar ndjekja penale për 498 proçedime penale, prej të cilave 343 çështje të regjistruara të reja, 19 çështje të ardhura me moskompetencë dhe ,si dhe 136 proçedime penale të mbartura nga viti 2019.

Gjatë vitit 2020, në krahasim me vitin 2019 në këtë prokurori për veprat në fushën e narkotikëve rezultojnë se janë regjistruar si procedime penale të reja gjithsej 16 çështje penale më pak, por vërehet se është rritur numri i çështjeve të regjistruara për N.284 të K.Penal në lidhje me kultivimin e bimëve narkotike.

**Çështje penale të hetuara për vitin 2020**  
N.283,283/a e 284 të K.P



**Çështje penale të hetuara për vitin 20219**  
N.283,283/a,284 K.P



Në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve vlen për tu theksuar se problematike për hetimin e tyre mbeten kryerja e ekspertimeve toksikologjike, tekniko-kompjuterike në lidhje me telefonat e sekuestruar, si dhe ato mjeko-ligjore në lidhje me faktin e përcaktimit të dozës së sekuestruar, nëse përbën dozë për përdorim vetjak apo jo.

**II.1 PËRFUNDIMI I ÇËSHTJEVE PËR VITIN 2020**

Tabela në vijim, paraqet në mënyrë të përmblëdhur të dhënat për mënyrën e përfundimit të procedimeve penale gjatë hetimeve paraprake, si dhe numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim.

	Mënyra e Përfundimit							
	Nr.Proçedime penale		Nr. i personave në hetim		Nr. i të Pandehurve		Nr.Personave në gjendje arresti	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjyqit	3108	<b>2892</b>	---	---	3716	<b>3414</b>	712	<b>716</b>
Pezulluar	3900	<b>3397</b>	---	---	---	---	---	---
Pushuar	1831	<b>1623</b>	676	<b>611</b>	---	---	13	<b>16</b>
Transferuar	679	<b>368</b>	629	<b>323</b>	---	---	15	<b>1</b>

<b>Gjithsej përf</b>	9518	<b>8280</b>	1305	<b>934</b>	3716	<b>3414</b>	740	<b>735</b>
<b>Hetim</b>	3437	<b>4334</b>	900	<b>1135</b>	---	---	22	<b>21</b>

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme evidentohet se, **2892** procedime janë dërguar për gjykim me **3414** persona të pandehur, nga të cilët: **716** me masë sigurimi arrest dhe **2698** me masa të tjera sigurimi dhe në gjendje të lirë. Nga këta **521** proçedime janë dërguar për gjykim çështje të veprave penale kundër personit, **825** për veprat penale kundër pasurisë, **1471** kundër autoritetit të shtetit, dhe **71** në fushën kundër drejtësisë. Janë pezulluar **3397** proçedime penale, dërguar për kompetencë **368** proçedime me **323** persona nën hetim. Janë pushuar **1623** proçedime me **611** persona nën hetim nga të cilët **16** persona me masë sigurimi shternguese “arrest në burg” dhe “Arrest në shtëpi”, dhe **595** persona me masa të tjera sigurimi dhe në gjendje të lirë. Për vitin 2020 janë mbartur **4334** proçedime me **1135** persona në hetim. Në tabelën vijuese paraqitet shpërndarja e proçedimeve penale të regjistruara sipas veprave penale të grupuara në krerët e Kodit Penal dhe mënyra e tyre e përfundimit.


Veprat penale të grupuara sipas krerëve	Nr. Proc.	Mënyra e Përfundimit				
		Gjyqit	Pushuar	Pezulluar	Komp.	Hetim
Kr.II V.P K/Personit	<b>1426</b>	<b>521</b>	<b>322</b>	<b>85</b>	<b>7</b>	<b>491</b>
Kr.III V.P K/Pasurisë dhe Ekonomi	<b>6759</b>	<b>825</b>	<b>566</b>	<b>2948</b>	<b>49</b>	<b>2371</b>
Kr.IV V.P K/Mejdisit	<b>32</b>	<b>2</b>	<b>10</b>	<b>9</b>	<b>2</b>	<b>9</b>
Kr.V Krime K/Pavarës. R/K	<b>8</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	-	<b>4</b>
Kr.VI Krime Cën/Marrdh.Shte	-	-	-	-	-	-
Kr.VII Akte Terroriste	<b>6</b>	<b>1</b>	-	<b>1</b>	-	<b>4</b>
Kr.VIII V.P K/Autorit.Shtetit	<b>4156</b>	<b>1471</b>	<b>672</b>	<b>335</b>	<b>308</b>	<b>1370</b>
Kr.IX V.P K/Drejtësisë	<b>222</b>	<b>71</b>	<b>49</b>	<b>17</b>	<b>2</b>	<b>83</b>
Kr.X V.P Prekin. Zgjedh. e Lira	<b>5</b>	-	<b>2</b>	<b>1</b>	-	<b>2</b>
Vepra të tjera	-	-	-	-	-	-

<b>TOTALI</b>	<b>12614</b>	<b>2892</b>	<b>1623</b>	<b>3397</b>	<b>368</b>	<b>4334</b>
---------------	--------------	-------------	-------------	-------------	------------	-------------


Sikurse shihet nga të dhënat e mësipërme, pjesën më të madhe e zënë procedimet penale për veprat penale kundër pasurisë, kundër autoritetit të shtetit dhe kundër personit.

Për këtë grup procedimesh penale, treguesit më pozitivë janë ato në lidhje me veprat penale të parashikuara në Kreun II dhe VIII-të, mbasi për veprat penale të parashikuara në Kreun III, numri i proçedimeve penale të pezulluara është relativisht i madh.

Veprat penale që lidhen me pronën kanë njohur ulje. Janë regjistruar në total **6759** proçedime penale, që përbëjnë **166** proçedime penale më pak krahasuar me vitin 2019, veprat penale kundër kundër autoritetit të shtetit janë më pak se një vitë me parë dhe janë regjistruar rreth **132** proçedime më pak se një vit më parë. Po kështu edhe veprat penale kundër personit, ku janë regjistruar **29** proçedime më pak.



Grafiku vijues ilustron për vitet 2019 dhe 2020 proçedimet penale të regjistruara rishtazi dhe të mbartura nga vitet përkatëse:



Gjatë kësaj periudhe, për hetimet paraprake është vendosur zgjatja e afatit të hetimit deri në tre muaj në **301** procedime për **460** persona nën hetim, (prej të cilëve **123** kanë qenë me masë sigurimi arrest në burg); deri në gjashtë muaj në **133** proçedime për **225** persona nën hetim (prej të cilëve **42** kanë qenë me arrest në burg); deri në nëntë muaj në **49** proçedime për **75** persona nën hetim (prej të cilëve **16** kanë qenë me arrest në burg); dhe deri në 12 muaj në **28** proçedime për **50** persona nën hetim (prej të cilëve **2** kanë qenë me masë sigurimi arrest në burg), dhe mbi një vit janë në **21** proçedime për **39** persona nën hetim (prej të cilëve **2** kanë qenë me masë sigurimi arrest në burg).

Në krahasim me një vit më parë konstatohet se është rritur numri i çështjeve me zgjatje afati në të gjitha periudhat. Përgjithësisht zgjatjet e afatit të hetimit kanë qënë të motivuara dhe janë

vendosur në ato raste kur hetimet kanë qënë komplekse. Megjithatë, numri i zgjatjeve të afatit do të ishte më i ulët, në rast se strukturat e hetimit të shërbimeve të policisë gjyqësore në Drejtorinë Rajonale Vendore Tiranë dhe strukturave në varësi të saj, do të ishin më të impenjuara në kryerjen në kohë të veprimeve të deleguara nga prokurorët.

Në tabelën në vijim, paraqiten të dhëna të detajuara për vepra penale të caktuara sipas tabelës vijuese:

Akuza	Nr Procedimi	Pandeh	Gjyqit			Pushuar			Pezu lluar	Kopetenc		Gjithsej Përf		Në Hetim	
			Proc	Pandehur	Zyrtar	Proc	Pan+perso	Zyrtar		Proc	Pan+perso	Proc	Pan+pero	Proc	Pan+perso
137	98	30	26	26	-	7	2	-	23	-	-	56	30	42	2
174	22	4	2	2	-	2	1	-	6	-	-	11	4	11	-

175	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-
177	3	5	1	1		1	4	-	-	-	-	2	4	1	-
178	19	32	7	29	-	4	2	-	-	-	-	11	31	8	9
180	132	40	20	26	-	25	3	-	2	4	2	50	31	82	9
181	56	20	9	20	-	9	-	-	1	-	-	19	20	37	-
181/a	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
183	31	8	3	3	-	5	1	-	14	-	-	22	4	7	4
199/a	523	231	208	211	-	145	13	-	2	-	-	356	225	167	6
244	6	5	-	-	-	-	1	-	-	5	4	5	5	1	-
245/1	2	3	-	-	-	1	-	-	-	-	2	1	2	1	1
248	351	101	14	23	-	98	37	-	5	17	3	134	63	217	38
256	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
258	12	4	-	-	-	3	-	-	-	10	4	10	4	2	-
259	11	5	-	-	-	2	2	-	-	6	-	8	2	3	3
287	157	19	3	7	-	17	6	-	10	4	1	34	7	126	9
291	1159	1107	915	918	-	54	50	-	-	1	1	970	969	189	138
312	1	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	1	-	-	-

## II.2 PROCEDIME PENALE TË PËRFUNSUARA ME KËRKESË PËR PUSHIM


Në tabelën në vijim, paraqiten në mënyrë të përmblëdhur procedimet penale të pushuara, gjendja e masës së sigurimit për personat nën hetim apo të pandehur, si dhe shkaqet pse është vendosur pushimi.

Nr.Proç	Persona	Arrest	Pushuar akuza					
			M.Fakti		M.Prove		Të tjera	
			Çështje	Persona	Çështje	Persona	Çështje	Persona
1623	611	6 arrest burg	1138	371	147	101	337	137
		10 arrest shtepie						

N.q.s i bëjmë një analizë shkaqeve për të cilat është vendosur pushimi i çështjes, konstatojmë se ne **1138** raste është vendosur pushimi i çështjes për mungesë fakti, në **147** raste është vendosur pushimi për mungesë provash.



Nga **1623** procedime penale të pushuara, në **1240** prej tyre nga ana e prokurorit në bazë të ndryshimeve të K.Pr. Penale është bërë kërkesë në gjykatë për pushimin e procedimit penal (në numrin total të pushimeve janë llogaritur dhe ato kërkesa për pushim ku ende nuk ka vendimmarrje nga gjykata) dhe në **382** procedime penale është vendosur pushimi nga prokurori.



### **II.3 PROCEDIME PENALE ME HETIME PROAKTIVE**

Gjatë vitit 2020, janë regjistruar një sërë procedimesh penale me hetime proaktive, të cilat i takojnë të gjitha linjave të prokurorisë. Këto procedime penale janë regjistruar për veprat penale si: shpërdorimi i detyrës, veprat penale në fushën e narkotikëve, krimet kundër jetës dhe shëndetit etj. Duhet nënvizuar se nga ana e prokurorëve i është dhënë rëndësia e duhur aplikimit të metodave speciale të hetimit, si mënyrë shumë e rëndësishme dhe në shumë raste e vetme, për të siguruar mbledhjen e provave të mjaftueshme për provueshmërinë e akuzës.

Por gjithmonë, është treguar kujdesi i duhur në momentin e regjistrimit me qëllim që të administrohet një bazë sa më e plotë e të dhënave.

### **II.4 VEPRA PENALE TË RËNDA TË HETUARA NË VITIN 2020**

Gjatë këtij viti janë hetuar **534** procedime penale për vepra penale të rënda si vrasje me dashje, vrasje me paramendim, vrasje në rrethana të cilësuar, plagosje të rëndë, shfrytëzim prostitucioni, prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike, vjedhje me armë, vjedhje me pasojë vdekjen, etj., me **472** persona të pandehur/nën hetim, nga të cilët **113** me masë sigurimi “arrest në burg”.

Përsa i takon mënyrës së përfundimit të tyre evidentohet se, **129** procedime penale janë dërguar për gjykim, **127** janë pushuar, **59** janë pezulluar dhe për **2** është shpallur moskompetenca. Treguesit

sasiorë për veprat penale të rënda, janë pak më të larta se viti 2019 në disa nga treguesit dhe konkretisht me **40** procedime penale më shumë, janë më pak dosje të dërguara për gjykim, rreth **28** procedime penale më pak me **14** persona nën hetim më shumë. Ka më shumë procedime penale të pushuara, **22** procedime penale më shumë.

Në mënyrë më të detajuar, shpërndarja e procedimeve penale për vitin 2020 sipas veprave penale të rënda dhe mënyra e përfundimit të tyre, paraqitet në tabelën në vijim:


Akuza	Nr.Proc	Pandehur + ne hetim	Arrest	Mënyra përfundimit				
				Gjyqit	Pushuar	Pezull	Mosk	Hetim
<b>76</b>	14	14	5	5	2	2	-	5
<b>78</b>	12	4	2	2	1	4	-	5
<b>79</b>	8	3	3	2	-	3	-	4
<b>88</b>	38	33	19	14	7	4	-	13
<b>100</b>	6	2	-	-	1	-	1	4
<b>101</b>	8	9	7	3	1	-	-	4
<b>114</b>	23	12	1	3	4	1	-	15
<b>140</b>	7	12	12	2	-	2	-	3
<b>141</b>	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>283</b>	418	383	64	98	111	42	1	166
<b>Gjith</b>	<b>534</b>	<b>472</b>	<b>113</b>	<b>129</b>	<b>127</b>	<b>59</b>	<b>2</b>	<b>219</b>

## II.5 DOSJET E RIFILLUARA NE VITIN 2020

Tabela në vijim paraqet të dhënat për procedimet penale për të cilat është vendosur rifillimi i hetimeve, si dhe mënyrën se si është proceduar më tej me to.

Rifilluar		Gjyqit		Pushuar			Pezull	Transf	Në hetim					
Çësh	Pande dhe ne hetim	Çësh	Pande dhe ne hetim	Çësh	N.66.kp	Pande dhe ne hetim			Çësh	Pand				
	A		Lirë			A	Lirë	A		Lirë				
<b>65</b>	<b>2</b>	<b>17</b>	<b>9</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1</b>	<b>35</b>	<b>3</b>	<b>13</b>	<b>0</b>	<b>3</b>

Në bashkëpunim me shërbimet e policisë gjyqësore, i është kushtuar një vëmendje e veçantë analizës së dosjeve të pezulluara, me qëllim që të kryheshin veprime të tjera hetimore për zbulimin e autorëve të veprave penale. Për rrjedhojë, këtë viti janë rifilluar hetimet në 65 proçedime penale, prej të cilëve 9 proçedime janë dërguar për gjykim me 10 të pandehur. Në 6 raste është vendosur pushimi i çështjes dhe në 35 raste hetimet janë pezulluar përsëri. Në hetim ndodhen ende 13 proçedime penale me 3 person në hetim në gjendje të lirë.



## **II.6 MASAT E SIGURIMIT PERSONAL NË VITIN 2020**


Edhe gjatë këtij viti është synuar që në një shumicë rastesh të aplikohen masa sigurimi të ndryshme nga ajo e “arrestit në burg”, duke mos e konsideruar këtë si një “zbutje” të qëndrimit të prokurorit, por duke i qëndruar korrekt kritereve për caktimin e masave të sigurimit personal. Në momentin e caktimit të masave të sigurimit është patur veçanërisht në konsideratë vlera që ka masa e sigurimit për fazën e hetimeve paraprake dhe jo mentaliteti që e lidh detyrimisht aplikimin e dënimit me burgim, me llojin e masës së sigurimit.

Gjithmonë është patur parasysh që lloji i masës së sigurimit të caktuar nuk përcakton për asnjë çast masën e dënimit që do të kërkohet nga prokurori dhe do të caktohet më tej nga Gjykata ndaj të pandehurit në rastin kur ai gjendet fajtor për veprën penale. Megjithatë, në një pjesë rastesh, masat e sigurimit të caktuara nga ana e Gjykatës kanë qenë më të buta se ato të kërkuara nga ana e prokurorit. Këtë vit mund të përmendin rastet e aplikimit nga ana e gjykatës të masës së sigurimit të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale pa respektuar kriteret ligjore për këtë masë sigurimi, ndërkohë që nga ana e prokurorisë është vazhduar t’i kushtohet vëmendje, aplikimit sa më pak të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”.

Treguesit për masat e sigurimit të kërkuara nga prokurori dhe atyre të vendosura nga ana e Gjykatës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Kërkesa e prokurorit											
A.Burg		A.Bu.afat		A.Shtëpi		Gar.pas.		Det.p.para		Pez.usht.	
2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
665	670	23	17	93	135	1	3	1065	1048	-	-
Vendimi i gjykatës											
A.Burg		A.Bu.afat		A.Shtëpi		Gar.pas.		Det.p.para		Pez.usht.	
2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
568	581	17	16	159	204	1	3	1103	1069	-	-

Për të krijuar një perceptim vizual të diferencës, të dhënat e mësipërm paraqiten edhe në formën grafike si më poshtë:



Krahasuar me vitin 2019 rezulton se, nga ana e prokurorisë ka patur **1** kërkesë më pak për caktim mase sigurimi arrest në burg. Numri i masave të sigurimit “arrest në burg” të kërkuara nga prokurori është **90** më tepër se sa ato që janë caktuar nga ana e gjykatës. Ndërkohë që Gjykata ka caktuar masë sigurimi “arrest në shtëpi” në **69** raste më tepër se sa ka kërkuar prokurori.

Në **6** raste nga ana e prokurorit është bërë apel kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit. Nuk është bërë apel në ato raste kur, në seancën e vlerësimit të arrestit dhe të caktimit të masës së sigurimit janë paraqitur rrethana të reja që lidhen me normalizimin e marrëdhënieve mes


palëve, në lidhje me personalitetin e të dyshuarve dhe sidomos në lidhje me angazhime në shkolla etj. të cilat nuk dihen në kohën e përpilimit të kërkesave nga prokuroria. Gjatë vitit 2020, në 5 raste është urdhëruar lirimi i menjëhershëm i të arrestuarit mbasi arrestimet ishin bërë në kundërshtim me kërkesat e ligjit.

## II. 7 TREGUESIT KRYESOR TË KRAHASUAR ME VITIN 2019

Në mënyrë të përmblodhur treguesit kryesorë të hetimit për vitet 2019 dhe 2020 paraqiten në tabelën në vijim:

Viti	Nr.pr.pen.	Gjyqit	Pushuar	Pezull	Transf	Hetim	Nr.mosf
2019	12955	3108	1831	3900	679	3437	8116
2020	12614	2892	1623	3397	368	4334	6787
Diferenca	<b>-341</b>	<b>-216</b>	<b>-208</b>	<b>-503</b>	<b>-311</b>	<b>897</b>	<b>-1329</b>

Me qëllim perceptimin vizual të të dhënave krahasuese tabela e mësipërme paraqitet dhe me grafikun si më poshtë:



### III. Forcimi i kapaciteteve të bashkëpunimit

Në këtë prokurori, është treguar një vëmendje e posaçme për vënien e rrugëve të mira për bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm, me qëllim realizimin e luftës ndaj kriminalitetit në përgjithësi, por në një vështrim më të hollësishëm, veprave penale që lidhen me dhunën me bazë gjinore, apo sigurimin e të drejtave më të përforcuara ndaj të miturve.

Përfaqësues të kësaj prokurorie prokurorë apo oficerë të policisë gjyqësore kanë marrë pjesë vazhdimisht në mbledhjet e grupeve të punës me aktorë të tjerë institucionalë ose jo institucionalë të krijuara në kuadër të planeve konkrete.

Në punën e tyre, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, shfrytëzojnë në maksimum bashkëpunimin me agjensitë e tjera ligjzbatuese, me institucionet e ndryshme shtetërore, siç janë për t'u theksuar

Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Inspektoriatet përkatëse të Mjedisit, të Ndërtimit, Ministrinë përkatëse etj.

Një bashkëpunim i ngushtë ka qenë dhe me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, institucione këto ku janë transmetuar nga ana jonë shqetësimet në punën tonë në zbatim të ligjit, si dhe njohja me/dhe zbatimi i Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, zbatimin e vendimeve të KLP-së, si dhe raportimi në kohë dhe sa më i saktë i të dhënave statistikore apo informacioneve të kërkuara.

Bashkëpunim i ngushtë është mbajtur edhe me Prokurorinë e Apelit, Tiranë ku nga prokurorët e Prokurorisë së Apelit janë dërguar sa më shpejt që është e mundur njoftimet në lidhje me përfundimin e gjyqimeve në apel dhe sidomos në lidhje me kërkesat e prokurorëve në fazën e hetimeve paraprake.

Gjithashtu nga secili prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si verbalisht, ashtu dhe në mënyrë shkresore, ju është dhënë në kohë informacioni prokurorëve të apelit në lidhje me problematikat e hasura gjatë gjyqimit në Gjykatën e Apelit, të ankimeve të bëra nga prokurorët e shkallës së parë.

Nga Prokuroria është treguar një kujdes i vecantë në lidhje me kthimin e përgjigjeve, dërgimin e informacioneve dhe dokumentacioneve të kërkuara nga organet e krijuara në kuadër të Reformës në Drejtësi për zbatimin e procesit të vlerësimit kalimtar që janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Sipas parashikimit të legjislacionit përkatës procedural penal, si dhe ligjeve përkatëse për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të prokurorisë dhe gjykatës një bashkëpunim i vecantë është mbajtur dhe me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përsa i përket gjyqimit në kohë të kërkesave të prokurorëve gjatë fazës së hetimit paraprak, konstatimit të problematikave të ndryshme në lidhje me pjesmarrjen e prokurorëve në seanca gjyqësore dhe respektimin e solemnitetit në këto seanca gjyqësore.

Një bashkëpunim i ngushtë gjatë vitit 2020 ka qenë dhe me Shkollën e Magjistraturës, ku nga prokurorët në vazhdimësi është ndjekur procesi i trajnimit vazhdues për rritjen profesionale dhe specializimin e prokurorëve për njohje dhe zbatim të legjislacionit penal dhe praktikat më të mira gjyqësore kombëtare apo ndërkombëtare.

Në rastin kur agjensi të tjera dërgojnë ftesa që lidhen me çështje të vecanta, janë propozuar fillimisht të shkojnë prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore të caktuar pikërisht në seksionet përkatëse dhe në rast pamundësie objektive të tyre, kanë shkuar prokurorët apo oficerët e tjerë të policisë gjyqësore. Bashkëpunimi ndërkombëtar, shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës, organizimi i operacioneve të përbashkëta dhe mbështetja logjistike dhe financiare nga partnerët ndërkombëtarë është po aq i rëndësishëm në suksesin e luftës kundër kriminalitetit.

Përsa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, konstatohet se ekziston një bashkëpunim i frytshëm, në drejtim të kërkesave për ndihmë juridike të sjella nga shtetet e huaja.

Në lidhje me marrjen e masave për respektimin e standarteve etike dhe profesionale në funksion të forcimit të integritetit të prokurorëve, siç theksuam edhe më sipër, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e ushtrojnë funksionin e tyre të ndarë në seksione, sipas grup veprave penale. Në krye të secilit seksion është Drejtuesi i Seksionit, i cili ndihmon Drejtuesin në detyrën e tij, në lidhje me respektimin e këtyre standarteve.

Prokurorët, gëzojnë pavarësinë në çështjet penale konkrete, dhe në respektim të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dispozitave procedurale penale, mbi bazë

të ankesave të qytetarëve apo kompleksiteteve që paraqesin çështjet, nga Drejtuesi i Prokurorisë janë ndërmarrë hapa për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështjet penale si dhe krijimit të grupeve hetimore. Është respektuar vendimmarrja e prokurorit, duke u përpjekur pavarësisht volumit të madh të punës, që të jepen udhëzime të cituara më lart.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, ka qenë e hapur ndaj çdo kërkesë të publikut, që lidhet me etikën dhe anën profesionale të prokurorëve, duke i dhënë përgjigje dhe ndërmarrë masat e duhura.

Prokurorët janë zëvendësuar vetëm në respektim të kriterëve dhe kushteve që përcakton ligji procedural penal duke respektuar mendimin e prokurorit mbi baza objektive.

Vlen për tu theksuar se pavarësia e prokurorit në ushtrimin e funksioneve procedurale në kryerjen e hetimeve, përfaqësimin e akuzës dhe/ose çështjes në gjyq dhe urdhërimin ose mbikqyerjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale, duhet të lidhet ngushtë me detyrueshmërinë e ndjekjes penale dhe zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e prokurorisë.

Gjithashtu janë përcaktuar qartë raportet apo marrëdhëniet administrative dhe funksionale ose procedurale penale ndërmjet prokurorit me drejtuesin e prokurorisë, dhe drejtuesit e seksioneve.

Nga prokurorët duhet të kuptohet qartë se pavarësia e prokurorit është pavarësia dhe autonomia e tij për marrjen e vendimeve në kryerjen e hetimeve, ndjekjen penale, përfaqësimin në gjyq të çështjeve dhe/ose akuzave penale dhe urdhërimin ose mbikqyerjen e ekzekutimit të vendimeve penale, pamvarsisht ndikimit të paligjshëm të drejtëpërdrejtë ose të të tërthortë, të brendshëm apo të jashtëm nga cdo autoritet publik, privat, ose palë e interesuar në procesin e ndjekjes penale.

Prokurorët duhet të kuptojnë qartë se detyrueshmëria e ndjekjes penale është një detyrim kushtetues dhe ligjor i tyre.

Veprimtarinë e tyre prokurorët detyrimisht duhet ta ushtrojnë duke ju nënshtruar Kushtetutës, akteve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj dhe legjislacionit të brendshëm në fuqi, duke respektuar parimet e një procedimi të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, si dhe duke mbrojtur liritë, të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve, si dhe interesin e shtetit dhe atë publik në procesin penal.

Në lidhje me përdorimin e sistemit elektronik CAMS, është përdorur vazhdimisht për shpërndarjen e çështjeve me short elektronik.

Gjatë vitit 2020 nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane, në respektim të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dispozitave procedurale penale, i është treguar kujdes i vecantë edhe përsa i përket njohjes dhe zbatimit të së Urdhërave dhe Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.

Ka patur dhe raste të marrjes se kohës në funksion të kuptimit të udhëzimit si dhe në drejtim të krijimit të kushteve teknike për të bërë të zbatueshëm atë.

Në kuadrin e zbatimit të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2019” të dt.18.06.2020 , Urdhërit nr.103 datë 17.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020”, Vendimit nr.501 dt.24.06.2020 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorinë e Përgjithshme, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2020”, si dhe Udhëzimit të Përgjithshëm nr.11 dt.20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane janë marrë masat e nevojshme organizative për zbatimin e kërkesave/rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave për vitin 2020.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë janë nxjerrë Urdhëra dhe Udhëzime të ndryshme për të mundësuar zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu nga Drejtuesi i Prokurorisë, në vazhdimësi gjatë vitit 2020 janë nxjerrë urdhra të ndryshëm për mirëfunksionimin e punës së administratës, riorganizimet e seksioneve në prokurori, verifikimin e ecurisë së çështjeve, përballimin e gadishmërisë së përgjithshme dhe gadishmërisë në situata të vecanta për shkak të pandemisë “Covid-19”, si dhe në varësi të ngarkesës së prokurorëve dhe përjashtimin e tyre nga shorti elektronik .

### III. VEPRIMTARIA GJATË FAZËS SË GJYKIMIT

#### III.1 PROCEDIME PENALE TË GJYKUARA

Tabela në vijim, paraqet treguesit për gjithë procedimet penale të gjykuara në periudhën objekt analize. Në këtë tabelë paraqiten të dhëna edhe lidhur me llojin e gjyqimit, kërkesat e prokurorit për masën e dënimit, rastet e tërheqjes së akteve ose akuzës, si dhe numri i apelimeve që u është bërë vendimit të gjykatës.

Nr.procedim		Numri i te pandehurve						Lloji Gjyqimit						Ankime	
		Arrest		Masa te tjera sig. e te lire		Gjithsej		Zakonsh		Shkurtuar		Dpd			
2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	'19	'20	'19	'20
2463	2420	630	828	2231	1917	2861	2745	13	12	2450	2420	10	32	145	34


Gjatë vitit 2020, janë përfunduar gjykimet për **2420** procedime penale me **2745** të pandehur, nga të cilët **828** me masë sigurimi “arrest në burg” dhe **1917** me masa të tjera sigurimi dhe në gjëndje të lirë. Në lidhje me mënyrën e zhvillimit të gjyqimit vihet re se, në **12** raste është proceduar me gjykim të zakonshëm; në **2420** raste me gjykim të shkurtuar dhe në **32** raste me gjykim të drejtpërdrejtë.

Kërkesa e prokurorit								
Burg	Kusht	Gjobë	N. 63 K.P	M.Mjek	M.Edu	P.Gjyk	P.Çësh	T.Akte
909	1497	206	137	21	-	16	-	1



Vendimi i Gjykatës								
Burg	Kusht	Gjobë	N. 63 K.P	M.Mjek	M.Edu	P.Gjyk	P.Çësh	Pafajsi
839	1453		185	9	-	61	-	38

Me qëllim perceptimin vizual të tabelës së mësipërme dhe diferenca, të dhënat paraqiten edhe në grafikun vijues:



Treguesit e mësipërm, flasin qartë që edhe për këtë vit politika e dënimit e kërkuar nga prokurori.

Për vitin 2020 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dërguar në Gjykatë me kërkesën për “Miratimin e Urdherit Penal” 35 çeshtje penale me 35 të pandehur, nga keto Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka miratuar 34 Urdhëra Penal ndërsa 1 çeshtje refuzohet nga Gjykata dhe aktet janë kthyer Prokuroisë. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhje me “Kërkesë për Miratimin e Marrëveshjes Penale” janë dërguar 122 çeshtje penale me 122 të pandehur, nga këto 106 çeshtje penale janë miratura nga Gjykata dhe 16 marrëveshje janë refuzuar nga Gjykatata dhe është vendosur kthimi i akteve në prokurori. Pjesa me e madhe e çeshtjeve penale të dërguar në Gjykatë me “Kërkesë për gjykim” i dërgohet gjyqtarit të seancës paraprake.

### **III.2 PROCEDIME PENALE TË RËNDA TË GJYKUARA**

Gjatë këtij viti ka përfunduar gjykimi për 168 procedime penale për krime të rënda, me 322 persona të pandehur nga të cilët 180 të pandehur me masë sigurimi “arrest në burg”.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna në lidhje me procedimet penale të gjykuara, për një grup veprash penale të rënda.

Akuza	Nr. Çështje	Të pandehur		Lloji i gjykit			Lloji i dënimit					Pafajësi	Apel
		Pan	Arr	Za.	Shk.	D.	Burg	Gj	Ku	M.M	P.gj		
<b>76</b>	1	1	1	-	1		1	-	-	-	-	-	-
<b>78</b>	2	2	2	-	-		2	-	-	-	-	-	-
<b>79</b>	1	1	1	1	-		1	-	-	-	-	-	-
<b>88</b>	16	18	17	2	14		11	-	6	-	1	-	-
<b>114</b>	3	3	1	-	3		2	-	-	-	-	1	1
<b>140</b>	2	5	5	-	2		5	-	-	-	-	-	-
<b>283</b>	85	103	83	1	85		43	-	58	-	-	4	4
<b>Tot.</b>	<b>110</b>	<b>133</b>	<b>110</b>	<b>4</b>	<b>105</b>		<b>65</b>	-	<b>64</b>	-	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>10</b>

### **III.4 HETIMI DHE GJYKIMI I TË MITURVE**

Në lidhje me të pandehurit e mitur, nga të dhënat statistikore të vitit 2020 rezultojnë 165 të pandehur/nën hetim të mitur të hetuar.

Të miturit dërguar gjyqit në vitin 2020 janë **73** ku **71** janë meshkuj dhe **2** është femër.

Kriminaliteti i të miturit sipas veprave penale paraqitet si vijon:

Vjedhja e pasurisë përbën grupveprat penale të kryera më së shumti nga të miturit 14 deri 18 vjeç, e konkretisht nga **86** të pandehur të mitur.


Për **52** të mitur është aplikuar shmangia nga dënimi, sipas parashikimeve ligjore.

Një vepër tjetër penale problematike, për të cilën janë regjistruar **36** të pandehur/hetim të mitur është ajo e “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”.

Lidhur me veprat penale kundër personit, rezulton se **12** të mitur kanë kryer vepra penale drejtuar personit.

Për veprat penale lidhur me narkotikët janë regjistruar 5 të pandehur/hetim të mitur.

Pjesa tjetër e të miturve të regjistruar e hetuar kanë kryer vepra penale të tjera të cilat të veçuara nuk kanë peshë specifike të veçantë brenda totalit.



Masat e sigurimit me të cilat janë hetuar dhe gjykuar të miturit janë 2 të mitur me masën e sigurimit “arrest në burg”, 1 i mitur me masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, 4 të mitur me masën e sigurimit “detyrim për paraqitje”, 3 te mitur me masen e sigurimit “vendosja nen mbikqyrje”, pjesa tjetër në gjendje të lirë.

#### **IV. URDHËRAT E EKZEKUTIMEVE TË VENDIMEVE PENALE**

<b>URDHËRA GJITHSEJ</b>										
Burg perjetë	Burgim	Mjekim në instituc	Gjobë	Kusht	Shpenzime proceduriale	Mjekim amb.	Bashkim dënimesh	Orë pune	Kthim asgjësim dhe kalim në fv. të shtetit të provës materiale.	Dënime plotës

0	457	23	151	985	1508	48	16	348	427	89
<b>URDHERA TË EKZEKUTUARA</b>										
Burg.përjet.	Burgim	Gjobë	Dënime Me kusht	Orë pune						
0	327	46	294	210						
<b>URDHERA TË PA EKZEKUAR</b>										
Burg.përjetshem.	Burgim	Gjobë	Dënime me kusht	Orë pune						
0	130	105	691	138						

Në zbatim të pikes 5, të nenit 48 të ligjit nr.10193, datë 03.12.2009 dhe të udhëzimit të përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm “Për shpallje në kerkim nderkombëtar” të datës 29.06.2010, për personat e denuar me vendim të formës së prerë, një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe shpalljes në kerkim nderkombëtar të personave të denuar me vendim të formës së prerë. **Kështu për vitin 2020 janë nxjerre urdherat për shpallje në kerkim nderkombëtar për 46 persona të denuar në mungesë me vendim të formës së prerë.**

Për vitin 2020 janë bërë disa kërkesa për revokim të dënimeve alternative, 15 kërkesa për bashkim dënimesh.

Leterporosi nga jashtë – 94

Ekstradime nga jashtë – 22

Shpallje në kerkim nderkombëtar – 46

Heqje nga kerkimi nderkombëtar – 20

Njohje vendimesh penale të huaja – 10

## **V. PROBLEMATIKAT GJATË HETIMIT DHE GJYKIMIT**

Gjatë vitit 2018 është bashkëpunuar më shërbimet e policisë gjyqësore të institucioneve të ndryshme si ato të policisë së shtetit, Drejtorisë së Hetimit Tatimor, atij doganor, etj.

Këto struktura të policisë gjyqësore kanë bërë përpjekje për realizimin me sukses të veprimtarisë së tyre hetimore. Strukturat e policisë në shumicën e rasteve kanë njoftuar prokurorin për ngjarjet e ndodhura, duke mundur në këtë mënyrë pjesëmarrjen e tij në vendngjarje, apo edhe konsultimin për veprimet që do të kryhen.

Megjithatë gjatë punës janë vërejtur dhe problematikat si më poshtë vijon;

- Lëvizja e oficerëve të policisë gjyqësore.

(Problematika e mësipërme përbën një ndër shkaqet kryesore të vonesave në kryerjen e veprimeve hetimore të shpejta si edhe me cilësinë e hetimit).

- Nevoja e një trajnimi për oficerët e policisë gjyqësore lidhur me respektimin nga ana e tyre të normave procedural.

(Kjo bëhet e rëndësishme sidomos në veprimet hetimore që kryhen kryesisht në momentin e pare, veprime me iniciativë, dhe në kuadrin e ndryshimeve të ndodhura në Kodi e Procedurës Penale).

- Nevoja për konsultim me prokurorin në rastet e ndalimeve konform nenit 253 të K.Pr.Penale dhe rastet e arrestimeve në flagrancë ku dukshëm nga oficeri i policisë gjyqësore abuzohet me këtë kompetencë që ligji ia ka dhënë policisë.
- Numri i madh i dosjeve të referuara nga policia gjyqësore të cilat përfundojnë me vendimin e mosfillimit të prokurorit, me shkakun se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, ndërkohë që nga ana e oficerit që referon çështjen kanë qenë të gjitha mundësitë për vlerësimin më të drejtë të çështjes.
- Cilësia e referimeve të veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Në dosjen që referohet në Prokurori nuk ka asnjë akt provues, përjashtuar informacionit për referimin e veprës penale dhe nga ana e oficerëve nuk kryhet asnjë verifikim tjetër i nevojshëm për regjistrimin e veprës penale nga ana jonë. E njëjta problematikë konstatohet edhe në rastet e informacioneve të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, të cilat informojnë vetëm transaksione të dyshimta pa asnjë dyshim për aktivitet kriminal të mundshëm.
- Mendojmë se numri i oficerëve të policisë gjyqësore të Drejtorisë Hetimore të Tatimeve, Tiranë duhet të jetë më i madh, nisur nga fakti se procedimet e referuara dhe hetuara nga ky seksion janë jo të pakta në numër, voluminoze dhe me shumë veprime hetimore dhe ky seksion mbulon jo vetëm Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, por edhe prokurori të tjera gjë që bën të vështirë hetimin në rrethe të ndryshme dhe zgjat afatet e hetimit të

procedimeve penale. Gjithashtu mendojmë që në përbërjen e tyre duhet të ketë dhe specialistë me njohuri të posacme në fushën ekonomiko-financiare.

- I njëjti arsyetim i mësipërm vlen dhe për sektorin e krimit ekonomiko-financiar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Mendojmë se policia gjyqësore nuk duhet të merret me punë të tjera operative, sepse angazhimi i tyre me problematika të tjera zvarrit hetimin (mungesë në numrin e agjentëve).
- Në lidhje me Drejtorinë Hetimore të Doganave, çështjet e referuara nga ana e tyre janë shumë të pakta, dhe mbetet për tu përmirësuar.
- Të gjithë oficerët e policisë gjyqësore duhet të jenë të kujdesshëm në marrjen e adresave sa më të sakta si të personave që pyeten si deklarues po ashtu dhe të atyre që pyeten nën hetim, pasi pasaktësia e adresave shkakton problematikë gjatë fazës së hetimit, gjyqimit por vecanërisht ekzekutimit të vendimeve penale.

Persa i përket fazës së gjyqimit vlen të theksohet se pjesëmarrja e prokurorëve ka qenë në përgjithësi korrekte.

## **VI. ZËVENDËSIMI I PROKURORËVE**

Gjatë periudhës objekt analize, konstatohet zëvendësimi i prokurorëve në disa raste. Në disa raste është proceduar me vendim të drejtuesit për zëvendësimin e prokurorit. Shkaqet tipike për të cilat është vendosur ky zëvendësim janë:

**Së pari**, Kalimi i procedimeve penale për ndjekje të mëtejshme në nga një seksion në tjetrin ose në seksionin e të miturve, ku ndjekja e mëtejshme e procedimit penal është bërë nga prokurorët e këtyre seksioneve.

**Së dyti**, largimi i prokurorëve për shkak të procesit të rivlerësimit, mungesa e disa prokurorëve për arsye shëndetësore.

**Së treti**, Rastet e tjera të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale.

Janë hasur edhe pak raste të zëvendësimeve të panevojshme të cilat kryesisht kanë ardhur nga ankesat e palëve në proces, që kanë detyruar prokurorin që të japë pëlqimin për zëvendësimin e tij për të shmangur krijimin e mosbesimit.

## **IV. PROBLEMATIKAT E HASURA GJATË VITIT 2020**

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, referuar ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimeve të Drejtuesit të Prokurorisë, në punën e përditshme gjatë vitit 2020 janë konstatuar edhe problematika të ndryshme:

- Për shkak të situatë së krijuar për efekt të pandemisë Covid-19 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, janë kështu dhe pengesa në kryerjen e veprimeve hetimore apo dhe vijimësia normale e përditshme. Kjo problematikë lidhet sidomos me kryerjen në kohë të veprimeve hetimore.

- Konstatohet se jo në çdo rast zbatohen nga prokurorët e kësaj prokurorie udhëzimet dhe kryesisht ato udhëzime që në pjesën dërrmuese nuk janë zbatuar kanë të bëjnë pikërisht me raportimin e të dhënave statistikore. Kjo vjen edhe si pasojë e ngarkesës në punën e tyre në ushtrim të funksioneve sipas Kodit të Procedurës Penale dhe Kushtetutës. Për këtë arsye, në këtë raportim jemi munduar të pasqyrojmë në mënyrë më të plotë të gjitha të dhënat e grumbulluara pas një konsultimi me të gjithë prokurorët.
- Ka një sërë problemesh që rrjedhin nga përdorimi i shortit elektronik sipas sistemit CAMS, përveç përdorimit të rregullt të tij për hedhjen e shortit elektronik, prokurorët jo në çdo rast e kanë të mundur të pasqyrojnë hedhjen e të dhënave në sistem.

Së pari për shkak të ngarkesës së tyre në punë, hedhja e të dhënave në sistem, përse kohë prokurorët nuk asistohen personalisht nga sekretare apo oficerë të policisë gjyqësore, pasur parasysh ngadalësinë me të cilën punon ky sistem, është e vështirë për prokurorët të tregohen efektivë si në hetim, përfaqësim në gjykatë dhe hedhjen e të dhënave në sistem;

Së dyti: hedhja në short e materialeve, nëpërmjet sistemit elektronik, konstatohet se nuk bën një ndarje të barabartë të punës ndërmjet prokurorëve dhe për këtë shkak shpesh herë Drejtuesi i Prokurorisë detyrohet të përjashtojë prokurorë të caktuar nga shorti.

- Gjithashtu përse i përket të dhënave statistikore që raportohen në Prokurorinë e Përgjithshme është e nevojshme që të rishihen dhe përmirësohen tabelat statistikore, me qëllim që në to të gjejnë pasqyrimet e ndryshimeve të ndodhura. Në lidhje me kërkesat për informim rezultojnë të jetë ekzistues rregjistri i kërkesave të bëra në mbështetje të ligjit të sipërcituar, në të cilin shënohen kërkesat dhe kthimi i përgjigjes, sipas rubrikave përkatëse. Përse i përket mbajtjes së rregjistrave, rezultojnë se përgjithësisht është kryer një punë e mirë në drejtim të mbajtjes së pasqyrimet të të dhënave në sistemin manual dhe atë elektronik.
- Ka edhe disa mospërputhje me faktin, të cituara në këtë raport, gjë e cila ka ndodhur për shkak të mosraportimit në kohën e duhur nga prokurorët. Siç edhe u citua në pjesën e mësipërme të këtij raporti, vazhdimisht nga Drejtuesi i Prokurorisë, janë nxjerrë udhëzimet përkatëse, për mbledhjen e të dhënave statistikore për çështje të vlerësuara të një kategorie të veçantë.

Këto udhëzime rezultojnë të mos jenë zbatuar, pasi prokurorët paraqesin ankesa në lidhje me ngarkesën e tyre përse i përket hetimit dhe përfaqësimit në gjykim të çështjeve penale.

Duke qenë se punonjësit e administratës, janë ngarkuar me punë të ndryshme, në fakt edhe prej tyre, shpesh gjendet e vështirë për t'i ngarkuar me mbledhjen e të dhënave statistikore për çështje të caktuara, sipas udhëzimeve.

- Mungesa faktike e numrit të prokurorëve të caktuar në organikë, si dhe lëvizja e prokurorëve, ka sjellë si pasojë rritjen e ngarkesës së prokurorëve.
- Problematikë ngelet numri i vogël i punonjësve të administratës.
- Në lidhje me punën e oficerëve të seksionit të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës konstatohet se nga prokurorët u janë dhënë për hetim procedime penale të referuara nga shërbime të tjera të policisë gjyqësore, duke sjellë si pasojë ngarkesën me punë të këtyre oficerëve.
- Gjithashtu vërehet se dhe në ngarkesën e çështjeve në hetim të oficerëve të seksionit të policisë gjyqësore ka pabarazi të numrit të çështjeve të hetuar nga secili oficer.
- Në lidhje me punën e oficerëve të shërbimit të policive gjyqësore në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, duke përfshirë dhe ata të komisariatëve të policisë vërehet se :
  - o Mungesë profesionaliteti në përgatitjen e materialeve të para hetimore, duke mos u kryer të gjitha verifikimet e mundshme në lidhje me faktet e kallëzuar apo ngjarjet në kushte flagrante, si:
    - veprimet e para që lidhen me bendin e ngjarjes,
    - kryerje vendimesh ekspertimi autoteknik në lidhje me ngjarjet e aksidenteve automobilistike, pasi është konstatuar se materialet e referuara shoqërohen vetëm me vendime kryerje ekspertimesh mjeko-ligjore;
    - referimesh ngjarjesh në lidhje me aksidentet automobilistike të cilat nuk kanë sjellë pasojë në shëndet për shtetasit e përfshirë në aksidente, të cilat nuk përbëjnë shkak për regjistrimin e procedimeve penale, ndërkohë që këto ngjarje duhej të ishin trajtuar si çështje administrative nga shërbimet e policisë rrugore. Shkak i bërjes së këtyre referimeve është bërë dhe hezitimi i shërbimeve të policisë rrugore për

të proceduar për këto ngjarje në rrugë administrative, për shkak të ankesave të mundshme të shtetasve të përfshirë në ngjarje automobilistike.

Theksojmë se në këto raste, nëse do të kryheshin në bazë të ligjit të gjitha detyrat nga shërbimet e policisë rrugore dhe do të merreshin masat përkatëse po në bazë të ligjit, duke u dokumentuar ato korrektësisht, atëherë çdo punonjës policie nuk ka se pse të ketë frikë me përballjen me ankesat e shtetasve të ndryshëm, ndërkohë që dhe në K.Rrugor janë parashikuar dhe ankesat në lidhje me vendim marrjen e këtyre shërbimeve.

Në përgjithësi është vënë re një frymë e mirë bashkëpunimi mes shërbimeve të policisë në formatin sesi është organizuar ndarja e prokurorisë në seksione.

Një vëmendje e vecantë është shërbimet e policisë gjyqësore që lidhen me tatimet dhe doganat.

Nga puna e bërë rezulton se në shumë raste agjensitë e hetimit tatimor apo doganor janë mjaftuar vetëm me njoftimin pranë Drejtorisë Vendore të Policisë apo Komisaritet përkatëse të Policisë në varësi të kësaj Drejtorie, për konstatimin e rasteve të veprave penale në fushën e tatimeve apo doganave, duke mos plotësuar vetë tërë dokumentacionin përkatës dhe më pas bërjen e kallëzimeve penale në bazë të legjislacionit përkatës që rregullon fushën e veprimtarisë së tyre sic janë ligjet mbi procedurat tatimore, ligjet mbi akcizat, apo Kodi Doganor.

Në këtë mënyrë ngarkohet me veprime hetimore policia e shtetit, ndërkohë që në këto raste ajo duhet të ishte vetëm mbështetëse e veprimtarisë së këtyre agjensive ligjzbatuese.

Është për t'u theksuar se ndjehet nevoja e referimit me te plote të veprave penale nga organet tatimore, pasi ndodh shpesh që veprat penale në fushën e tatim taksave referohen nga policia gjyqësore, kur ndërkohë fakti që të rezultojë penal, duhet të jenë ezauruar procedurat administrative, gjë që nuk ndodh në rastet e referuara nga policia.

- Problematikë ka qenë moskryerja në kohë prej ekspertëve të Institutit të Policisë Shkencore të ekspertimeve të ndryshme të vendosura nga prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore, edhe pse prej drejtuesve të këtij institucioni në vazhdimësi janë shprehur shqetësime për ngarkesë të madhe me vendime kryerjesh ekspertimesh, mungesë vendi për mbajtjen e provave materiale të dërguara për ekspertim etj;

- Problematikë ka qenë kthimi i përgjigjeve në kohë sa më të shpejtë të shoqërive telefonike celulare në lidhje me informacionet e kërkuara nga prokurorët për numra telefoni celular apo abonentë të këtyre shoqërive, gjë që ka sjellë si pasojë vonesa në hetim;

## **VII. PRIORITETE TË PUNËS PËR PERIUDHËN E VITIT 2021**

Për vitin 2021, vijon të mbetet si prioritet kryesor përmirësimi i treguesve sasiorë dhe cilësorë të ndjekjes penale dhe të gjykimit. Për këtë qëllim do të synohet:

### **1. Rritje e rolit të prokurorit në drejtim të:**

Kontrollit të veprimtarisë së policisë gjyqësore. Kjo do të konsistojë në hetimin e gjitha versioneve të mundshme hetimore, duke evidentuar, fiksuar dhe marrë të gjitha provat që i takojnë ekzistencës së faktit kriminal dhe atyre të fajësisë. Përpilimin nga ana e policisë gjyqësore, në formën e duhur procedurale të gjitha akteve të hetimit paraprak, me qëllim shmangien e probleme të mundshme në momentin e gjykimit, në lidhje me vlefshmërinë dhe përdorshmërinë e tyre. Në çdo rast që do të evidentohen probleme të karakterit procedural, ato do të bëhen pjesë e një analize të hollësishme dhe të përgjegjshme me të gjithë stafin e policisë gjyqësore të sektorit përkatës.



## 2. Rritje e rolit të prokurorit në drejtim të:

Pjesëmarrjes në veprimet e para hetimore gjatë fazës së parë që lidhet me vendngjarjen.

## 3. Forcimi i integritetit të prokurorit.

Në vitin 2021, do të ketë një fokus të veçantë dhe do të përkrahet forcimi i integritetit të prokurorit në garantimin e pavarësisë së tij, sidomos në fazën e gjykimit, por duke siguruar nga ana tjetër llogaridhënien e tij sipas ligjit për veprimtarinë e prokurorit.

Gjatë fazës së gjykimit, prokurori nuk duhet të jetë i lidhur vetëm me qëndrimin e bërë në kërkesën e tij për gjykim, por luajaliteti duhet të jetë prezent në varësi të kushteve dhe rrethanave që do të rezultojnë në gjykim. Një qëndrim i tillë i prokurorit jo vetëm që do të hedhë tej *mitin* e krijuar për prokurorin që kërkon *gjithmonë maksimumin e dënimit të pandehurit*, por kjo pavarësi do të sjellë reagimin e duhur që nevojitet për çdo sjellje që shfaqet në hetim por edhe në gjykim.

Nga ana tjetër, me krijimin e Institucioneve të reja si Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Inspektoriati (Inspektori) të Lartë të Drejtësisë, pavarësia që parashikohet dhe do të motivohet për prokurorin tashmë do të ketë një etalon dhe një vlerësim më objektiv qoftë mbi profesionalizmin ashtu edhe për procedimin disiplinor të prokurorëve.

## 4. Rritja e rolit të prokurorit në drejtim të kryerjes së një hetimi të shpejte brenda një afati të arsyeshëm.

Do të synohet për rritjen e shpejtësisë në hetim. Kjo do të arrihet nëpërmjet një kontrolli të afateve të përcaktuara nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore, si dhe propozimi për fillimin e ecurisë disiplinore në ato raste kur konstatohen zvarritje.

## 5. Përmirësimi i punës për vijimin e gjykimit në formatin e gjykimit të drejtëpërdrejtë.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të personit, ç'ka do të arrihet nëpërmjet vlerësimit më me përgjegjësi të momentit të "arrestit në flagrancë" dhe "ndalimit". Ka ardhur koha, që organi i procedimit nuk duhet të bëhet më mburojë e abuzivitetit të policisë gjyqësore, për sa i takon këtij momenti. Aq më tepër, që kjo vëmendje duhet të rritet edhe në kërkesat tona për caktimin e masave të sigurimit personal, të cilat duhet detyrimisht që të jenë në përputhje me kriteret proceduriale të parashikuara për caktimin e tyre.

## 6. Forcimi i rolit të Drejtuesit dhe Drejtuesve të Seksioneve.

Duhet të forcohet kontrolli i drejtuesve të prokurorisë, ndaj prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale në hetim dhe gjykim, në drejtim të shpejtësisë në hetime, si dhe hetime objektive, me qëllim që hetimet duhet të jenë të argumentuara edhe me arsyetimin e nevojshëm mbi bazën e provave të administruara dhe kërkesat e ligjit.

Ky kontroll duhet të forcohet edhe për sa i takon strukturave të shërbimeve të policisë gjyqësore.

Megjithëse në vitin 2021, do të luftohet për të përmirësuar punën në përgjithësi dhe në drejtime të caktuara në veçanti, vlerësojmë se, në kushtet e një ngarkese tepër të madhe që përballon secili prokuror, kushteve të infrastrukturës (sidomos largësia me gjykatën, si për masat e sigurimit dhe

gjykimet e themelit), etj., bëhet akoma dhe më imediate rritja e numrit të prokurorëve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ulja e ngarkesës për secilin prokuror duke e afruar me atë që konsiderohet si ngarkesë normale e punës, mendojmë se do të sillte përmirësime në cilësinë dhe shpejtësinë e hetimit dhe do të rriste efikasitetin e ndjekjes penale.

Një shqetësim evident mbetet dhe largimi i prokurorëve për shkaqe të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë.

Në mënyrë të përmbledhur, këto ishin rezultatet e arritura dhe problemet e hasura gjatë veprimtarisë tonë një vjeçare.

Jemi të ndërgjegjshëm se, ndonëse janë konstatuar tregues sasiore dhe cilësorë në përgjithësi pozitivë, mbetet akoma punë që ato të arrijnë në nivele më të larta.

Besojmë se edhe bashkëpunimi ndërinstitucional do të ndikojë në përmirësimin e parametrave të punës.

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**ELIZABETA IMERAJ**